

L I G J
Nr. 8520, datë 30.7.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
TË SHQIPËRISË DHE PROGRAMIT BOTËROR TË USHQIMIT TË KOMBEVE TË
BASHKUARA”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8371, datë 9. 7. 1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Programit Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 2440, datë 13.8.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

MARRËVESHJE
**MIDIS QEVERISË SË SHQIPËRISË DHE PROGRAMIT BOTËROR TË USHQIMIT TË
KOMBEVE TË BASHKUARA**

Duke konsideruar se Qeveria e Republikës së Shqipërisë (më poshtë e quajtur “Qeveri”, dëshiron të përfitojë nga ndihma e Programit Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara (më poshtë i quajtur “Programi Botëror i Ushqimit”) dhe

Duke konsideruar se Programi Botëror i Ushqimit bie dakord të përballojë një asistencë sipas kërkesave specifike të Qeverisë.

Programi Botëror i Ushqimit dhe Qeveria kanë dhënë pëlqimin për këtë marrëveshje në frymën e bashkëpunimit miqësor, që pasqyrohet në termat dhe kushtet e përgjithshme në të cilat kjo ndihmë mund të jepet nga Programi Botëror i Ushqimit dhe të përdoret nga Qeveria në përputhje me rregullimet financiare e të përgjithshme, si dhe rregullat e Programit Botëror të Ushqimit.

Neni I

Kërkesat e asistencës dhe marrëveshjeve

1. Qeveria mund të kërkojë asistencë në formën e ushqimit nga Programi Botëror i Ushqimit për të mbështetur projektet e zhvillimit social dhe ekonomik ose për plotësimin e nevojave energjente ushqimore për ushqime që lindin nga fatkeqësi natyrore ose si rezultat i

kushteve të tjera emergjente.

2. Çdo kërkesë për asistencë normalisht do të paraqitet nga Qeveria në formën e treguar nga Programi Botëror i Ushqimit nëpërmjet përfaqësuesit të saj të emëruar nga Drejtori i tij Ekzekutiv dhe i akredituar në Republikën e Shqipërisë.

3. Qeveria do t'i sigurojë Programit Botëror të Ushqimit të gjitha lehtësitat dhe informacionin përkatës të nevojshëm për vlerësimin e kërkesës për një miratim zyrtar.

4. Me miratimin e kësaj marrëveshjeje Programi Botëror i Ushqimit do të japë asistencë në drejtim të zhvillimit të një projekti. Qeveria dhe Programi Botëror i Ushqimit do të miratojnë një plan veprimesh. Në rast emergjente për veprime bamirësie do të shkëmbehen letra mirëkuptimi.

5. Çdo plan veprimesh ose letër mirëkuptimi do të specifikojë termat dhe kushtet me të cilat një projekt do të realizohet duke përcaktuar përgjegjësitë përkatëse të Qeverisë dhe të Programit Botëror të Ushqimit në realizimin e projektit.

6. Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje bazë do të udhëheqin çdo plan veprimesh ose letër mirëkuptimi të konkluduar më poshtë. Marrëveshje të tillë (plane veprimesh dhe letra mirëkuptimi) i sigurojnë të drejtën Programit Botëror të Ushqimit: të vëzhgojë të gjitha fazat e programit dhe të veprimeve të projektit nga marrja e mallrave deri në përdorimin e tyre përfundimtar në vend, të kryejë po qe se është e nevojshme revizionin, si dhe të ndërpresë ose të heqë asistencën në raste të mospërputhjeve serioze me Planin e veprimit dhe projekteve të hartuara ndërmjet palëve nënshkruese. Ato do të bëjnë të mundur gjithashtu: sigurimin e të dhënave për shpërndarjen e ushqimeve dhe efektet e tij në përmirësimin e gjendjes ushqimore të përfituesve, si dhe në zhvillimin afatgjatë socialekonomik të vendit; mbajtjen e shënimeve të plot në lidhje me asistencën e Programit Botëror të Ushqimit, duke përfshirë transportin dhe dokumentet e ruajtjes, si dhe komunikimin e të dhënave të tilla Programit Botëror të Ushqimit, me kërkesën e tij.

Neni II

Ekzekutimi i projekteve të zhvillimit dhe veprimeve emergjente bamirëse

1. Qeveria ose një agjenci ekzekutuese e miratuar reciprokisht do të jetë përgjegjësia kryesore për ekzekutimin e projekteve të zhvillimit dhe veprimeve të emergjencës, siç përshkruhet në planin e veprimeve ose letrën e mirëkuptimit mbi të cilat bazohet realizimi i çdo veprimi zhvillimi ose emergjence në Republikën e Shqipërisë.

2. Programi Botëror i Ushqimit do të lëvrojë mallra në formë granti të çliruara nga detyrimet portuale, taksat doganore dhe kufitare, si dhe nga detyrimet e tjera në lëvrimin e mallrave brenda Republikës së Shqipërisë, për të cilat bihet dakord reciprokisht, si dhe do të monitorojë e do të japë asistencë këshillimore në ekzekutimin e çdo veprimi zhvillimi ose emergjence.

3. Për çdo projekt Qeveria do të caktojë në marrëveshje me Programin Botëror të Ushqimit, një agjenci të përshtatshme për të realizuar projektin. Nëse do të ketë më shumë se një projekt asistence ushqimi, Qeveria do të caktojë një agjenci qendrore koordinimi për rregullimin e furnizimeve të ushqimeve midis Programit Botëror të Ushqimit dhe Projekteve, si dhe midis vetë projekteve.

4. Qeveria do t'i sigurojë lehtësira Programit Botëror të Ushqimit për vëzhgimin e të gjitha fazave për realizimin e projekteve të zhvillimit dhe veprimeve të emergjencës.

5. Qeveria ose agjencia e caktuar do të sigurojë: (i) që mallrat e furnizuara nga Programi Botëror i Ushqimit, të merren në dorëzim, të ngarkohen, të transportohen, të magazinohen dhe të shpërndahen me kujdesin e kërkuar dhe me efikasitet; (ii) që procedurat e përdorura në shitjen e ndihmave të autorizuara, të jenë ato të rëna dakord midis palëve. Në rast se ato nuk janë përdorur kështu, Programi mund të kërkojë t'i kthehen atij mallrat ose procedurat e shitjes ose të dyja së bashku, sipas rastit. Kjo nuk aplikohet për ushqimet që manaxhohen, transportohen, magazinohen

dhe shpërndahen nga Programi Botëror i Ushqimit ose partnerët e tij.

6. Programi Botëror i Ushqimit mund të ndërpresë ose të tërheqë asistencën e tij në rast dështimi nga ana e Qeverisë, për të plotësuar çdo detyrim në bazë të kësaj marrëveshjeje ose çdo marrëveshje të përfunduar të lidhur me këtë.

Neni III

Asistencë nga burime të tjera

1. Në rast se asistenca që ka të bëjë me ekzekutimin e projektit sigurohet nga Qeveria nga burime të tjera nga ato të Programit Botëror të Ushqimit, palët do të konsultojnë njëra tjetrën me qëllim koordinimin më efektiv të asistencës së përfutur nga Programi Botëror i Ushqimit dhe burimet e tjera.

Neni IV

Informacion lidhur me projektet dhe veprimet e emergjencës

1. Qeveria ose agjencia e caktuar do t'i japë Programit Botëror të Ushqimit dokumente të tilla si: fatura llogarie, deklarata, raporte dhe informacione të tjera që Programi Botëror i Ushqimit mund të kërkojë lidhur me ekzekutimin e ndonjë projekti zhvillimi ose veprimi energjence, mbi mundësinë e vazhdimit ose që lidhet me plotësimin nga Qeveria të përgjegjësisë të saj, në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë marrëveshje të përfunduar të lidhur me këtë.

2. Qeveria ose agjencia e caktuar do të informojë rregullisht Programin Botëror të Ushqimit mbi ecurinë e ekzekutimit të çdo operacioni zhvillimi ose emergjence.

3. Qeveria ose agjencia e caktuar do t'i paraqesin Programit Botëror të Ushqimit, revizionimet e llogarisë të bëra nga revizorë të jashtëm mbi përdorimin e mallrave të furnizuara nga Programi Botëror i Ushqimit dhe mbi procedurat e shitjes së tyre kur janë të autorizuar, për çdo projekt në intervale të rëna dakord, si dhe në fund të çdo projekti.

4. Qeveria ose agjencia e caktuar do të marrë pjesë në çdo vlerësim projekti që Programi Botëror i Ushqimit mund të ndërmarrë në përputhje me planin përkatës të veprimeve ose Letrën e Mirëkuptimit, duke ruajtur dhe pajisur Programin Botëror të Ushqimit me të dhëna të plota të kërkuara për këtë qëllim. Çdo raport vlerësimi i përgatitur duhet të nënshkruhet nga Qeveria ose agjencia e emëruar për komentet e saj.

Neni V

Zyra e Programit Botëror të Ushqimit

1. Programi Botëror i Ushqimit mund të ngrejë dhe të mbajë zyra në Republikën e Shqipërisë nëse ajo e konsideron të nevojshme për të lehtësuar zbatimin e çdo veprimtarie që kryhet nën këtë marrëveshje bazë.

2. Programi Botëror të Ushqimit në marrëveshje me Qeverinë mund të ngrejë dhe të mbajë një zyrë rajonale/zonale në Republikën e Shqipërisë, për të realizuar programe mbështetjeje për shtetet e tjera në rajon/zonë.

3. Zyra e Programit Botëror të Ushqimit do të ushtrojë funksionet në përputhje me mandatin e saj dhe kërkesat operative të çdo projekti që zbatohet në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë vendosjen dhe mbajtjen e marrëdhënieve midis Programit Botëror të Ushqimit dhe organizatave të tjera qeveritare ose joqeveritare që funksionojnë në vend.

Neni VI

Personeli i Programit Botëror të Ushqimit

1. Programi Botëror i Ushqimit mund t'i paraqesë Republikës së Shqipërisë nëpunës të

tillë ose personel tjetër, nëse Programi Botëror i Ushqimit e konsideron të nevojshëm për të përmbushur detyrimet e tij në zbatimin e veprimtarisë së tij në Republikën e Shqipërisë.

2. Qeveria do të informohet nga Programi Botëror i Ushqimit lidhur me nëpunësit ndërkombëtar dhe me personelin tjetër që do të caktohen për veprimtaritë e Programit Botëror të Ushqimit në Republikën e Shqipërisë.

3. Afatet dhe kushtet e zënies në punë të personelit lokal të rekrutuar do të jenë në përputhje me Rezolutën, rregullimet dhe rregullat përkatëse të Kombeve të Bashkuara.

Neni VII

Lehtësitë për zbatimin e veprimtarive të Programit Botëror të Ushqimit

1. Qeveria do të marrë çdo masë e cila do të jetë e nevojshme për të lehtësuar nëpunësit e Programit Botëror të Ushqimit, ekspertët në mision dhe personat e tjerë që kryejnë shërbime në dobi të Programit Botëror të Ushqimit nga rregullimet apo klauzolat e tjera ligjore, të cilat mund të ndërhyjnë në veprimtarinë dhe projektet e kryera nën këtë Marrëveshje.

2. Qeveria do të asistojë Programin Botëror të Ushqimit sipas kërkesës së tij në gjetjen e objekteve të përshtatshme për zyra.

3. Qeveria, përsa do të bihet dakord reciprokisht, mbulon koston e pjesshme ose totale për ambientet e zyrave dhe lokalet e shërbimit, që përdoren nga Programi Botëror i Ushqimit për kryerjen e veprimtarive të tij në Republikën e Shqipërisë.

4. Qeveria do të sigurojë që ambientet e zyrave, që përdoren nga Programi Botëror i Ushqimit gjatë gjithë kohës, të jenë pajisur me shërbimet e nevojshme publike dhe se shërbime të tilla publike janë pajisur me terma të barabartë.

5. Qeveria do të marrë masat e nevojshme, kur kërkohen, për sigurimin dhe mbrojtjen e personelit, aseteve dhe i ambienteve të Programit Botëror të Ushqimit.

6. Qeveria kur të jetë e nevojshme do të lehtësojë lokalizimin e akomodimit të përshtatshëm shtëpiak për personelin ndërkombëtar të rekrutuar dhe për personat e tjerë që kryejnë detyra në dobi të Programit Botëror të Ushqimit.

7. Telekomunikacionet

- Programi Botëror i ushqimit për komunikime dhe telekomunikimet e tij zyrtare do të gëzojë trajtim jo më pak të favorshme se ato të akorduara nga Qeveria për ndonjë Qeveri tjetër, duke përfshirë misionet e saj diplomatike. Telekomunikacionet përfshijnë çdo transmetim, emetim apo marrje firmash, sinjalesh, shkrimesh, figurash (imazhesh), tingujsh apo informacion të çdo natyre me tel, radio, satelit, fibra optike apo mjetee të tjera elektronike ose elektromagnetike.

- Qeveria do të pajisë Programin Botëror të Ushqimit sipas kërkesës së tij me licenca dhe frekuenca për të mbajtur komunikimet me radio me njësitë e tij operative, kudo që janë vendosur të pandërprera për 24 orë, gjatë gjithë javës.

- Qeveria do t'i ofrojë Programit Botëror të Ushqimit të drejtën e importimit të të gjitha pajisjeve të nevojshme për komunikim pa vonesa doganore, konfiskime apo taksa.

- Qeveria do t'i ofrojë Programit Botëror të Ushqimit të drejtën për të instaluar dhe përdorur pajisjet e mësipërme nga zyrat dhe makinat e tij, si dhe për ato që përdoren nga anëtarët e tij me dorë.

- Qeveria do të sigurojë mosdhunimin e komunikimeve dhe korespondencës zyrtare të Programit Botëror të Ushqimit dhe nuk do të ushtrojë ndonjë censurë për komunikimet dhe korespondencën e tij. Një mosdhunim i tillë i pakufizuar do të përfshijë edhe publikime, fotografitë, diapozitivët, filmat dhe regjistrimet me zë.

- Programi Botëror i Ushqimit do të ketë të drejtë të përdorë kodet dhe të dërgojë e të marrë korespondenca dhe materiale të tjera me postë ose thasë të vulosur, të cilat do të gëzojnë të njëjtat privilegje dhe imunitete si thasët dhe postat diplomatike.

- Qeveria do t'i japë Programit Botëror të Ushqimit të gjitha lejet dhe licencat e

nevojshme për importimin e furnizimeve, pajisjeve dhe materialeve të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe do të sigurojë që të gjitha furnizimet, pajisjet dhe materialet të importohen pa vonesë dhe pa iu nënshtruar ndonjë kufizimi.

Neni VIII **Privilegjet dhe imunitetet**

1. Qeveria do t'i sigurojë zyrtarëve dhe konsulentëve të Programit Botëror të Ushqimit dhe personave të tjerë që kryejnë shërbime në emër të Programit Botëror të Ushqimit lehtësira të tilla, siç u sigurohen atyre të Kombeve të Bashkuara dhe agjencive të saj të specializuara.

2. Personat e rekrutuar në vend dhe të emëruar për të kryer shërbime për Programin Botëror të Ushqimit do të gëzojnë imunitet nga procesi ligjor lidhur me aktet e bëra nga ato në cilësinë e tyre si zyrtarë.

3. Qeveria do të zbatojë për pronat, fondet, asetet, zyrtarët e konsulentët e Programit Botëror të Ushqimit e të agjencive të specializuara të tij klauzolat e Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetet.

4. Qeveria do të jetë përgjegjëse për të trajtuar çdo pretendim, i cili mund të lindë nga palët e treta kundër Programit Botëror të Ushqimit apo zyrtarëve, konsulentëve të tij ose personave të tjerë që kryejnë shërbime në emër të Programit Botëror të Ushqimit nën këtë Marrëveshje, me përjashtim të rasteve kur bihet dakord midis Qeverisë dhe Programit Botëror të Ushqimit, që të tilla pretendime ose përgjegjësi janë rrjedhojë e neglizhencës së madhe apo drejtimit jo të mirë, të qëllimshëm nga persona të tillë.

5. Furnizimet, pajisjet ose materialet e tjera që nevojiten për veprimtaritë e mbuluara nga kjo Marrëveshje bazë nuk do t'i nënshtrohen asnjë takse të drejtpërdrejtë si TVSH, shpenzime, fatura apo detyrime të tjera.

Neni IX **Heqja e imunitetit**

1. Privilegjet dhe imunitetet që i garantohen personelit të Programit Botëror të Ushqimit në interes të Kombeve të Bashkuara dhe Programit Botëror të Ushqimit nuk janë për përfitim personal të individëve. Drejtori Ekzekutiv i Programit Botëror të Ushqimit do të heqë imunitetin e çdo personeli të Programit Botëror të Ushqimit në çdo rast kur sipas opinionit të tij/të saj imuniteti do të pengojë ecurinë e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa paragjykim në interes të Kombeve të Bashkuara dhe Programit Botëror të Ushqimit.

Neni X **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo marrëveshje midis Qeverisë dhe Programit Botëror të Ushqimit që rrjedh apo ka lidhje me këtë Marrëveshje, plan veprimesh ose letër mirëkuptimi, të cilat nuk mund të zgjidhen me negociata ose mënyrë tjetër zgjidhjeje të rënë dakord, do t'i paraqitet arbitrazhit me kërkesë të secilës palë.

Arbitrazhi, siç bihet dakord midis palëve do të mbahet në një vend jashtë vendit marrës. Çdo palë do të caktojë dhe komunikojë një gjyqtar dhe do të këshillojë palën tjetër për emrin e gjyqtarit të tij. Nëse gjyqtarët nuk bien dakord në një shpërblim, menjëherë do të caktojnë një gjykatës. Në rast se brenda 30 ditëve të kërkesës për arbitrazh, pala tjetër nuk ka caktuar një gjyqtar, ose gjyqtari i caktuar nuk bie dakord për shpërblimin dhe për caktimin e një gjykatësi, pala tjetër, sipas rastit, mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të caktojë një gjyqtar ose një gjykatës.

Shpenzimet e arbitrazhit do të mbulohen nga palët siç formulohet në shpërblimin e

arbitrazhit. Shpërblimi i arbitrazhit do të pranohet nga palët si një gjykim përfundimtar i mosmarrëveshjes.

Neni XI

Klauzola të përgjithshme

1. Marrëveshja do të hyjë në fuqi ditën që palët në kontratë informojnë njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave ligjore të miratimit apo të ratifikimit e do të vazhdojë të mbetet në fuqi deri në përfundimin e saj, sipas paragrafit 3 të këtij neni.

2. Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me marrëveshje me shkrim midis palëve. Çdo çështje përkatëse për të cilën nuk ka klauzola në këtë marrëveshje do të zgjidhen nga palët në përshtatje me rezolutat dhe vendimet e Bordit Ekzekutiv të Programit Botëror të Ushqimit. Secila palë do të japë një konsideratë të plotë për çdo propozim të bërë më parë nga pala tjetër nën këtë paragraf.

3. Kjo Marrëveshje mund të shpallet e përfunduar nëpërmjet njoftimit me shkrim të një nga palët drejtuar tjetrës dhe do të përfundojë gjashtëdhjetë ditë pas marrjes së këtij njoftimi. Pavarësisht nga një njoftim i tillë, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi, deri në plotësimin e plotë të përfundimit të të gjithë planeve të veprimit ose letrave të mirëkuptimit të bëra lidhur me këtë Marrëveshje Bazë.

4. Detyrimet e marra nga Qeveria në nenin V të saj do të jenë të vlefshme deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje siç cilësohet në paragrafin 3 të mësipërm, ku përcaktohet afati i nevojshëm që lejon tërheqjen në mënyrë të rregullt të pronësisë, fondeve dhe pasurive të Programit Botëror të Ushqimit, si dhe zyrtarëve e personave të tjerë që kryejnë shërbime në emër të programit Botëror të Ushqimit, në përputhje me këtë marrëveshje.

5. Kjo marrëveshje hartohet në dy gjuhë: anglisht dhe shqip. Në rastet e mosmarrëveshjeve, të cilat bëhen objekti i arbitrazhit, do të merret për bazë varianti i tekstit në anglisht.

Në dëshmi me poshtë nënshkruesit, të cilët janë caktuar përfaqësuesit e Qeverisë së Shqipërisë dhe Programit Botëror të Ushqimit të Kombeve të Bashkuara përkatësisht, në emër të palëve kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Tiranë, më 1. 5. 1999

Për Qeverinë e Shqipërisë

Për Programin Botëror të Ushqimit të
Kombeve të Bashkuara